

# STATUTI

## I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "V-MAX-2" SHPK

### HYRJE

#### NENI 1

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "V-MAX-2" sh.p.k eshte nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (sh.p.k).

Sot me date 10-10-2021, ortaku me identitet sa me poshte harton statutin e shoqerise, bazuar ne nenin 230/2 I ligjit 9901 date 14/04/2008

"Per tregtare dhe shoqerite tregtare".

- Klodiana Guzja , dtl 30-11-1984 lindur ne Tirane, dhe banues ne Tirane, madhor me zotesi te plote per te vepruar, me karte identiteti me nr I46130046A permbajtje sa vijon:

#### NENI 2

Shoqeria eshe krijuar dhe e zhvillon veprimtarine e saj ne perputhje me normat e ketij statuti, Ligjit 9901 dt 14/04/2008 "Per Shoqerite Tregtare dhe Tregtaret" si dhe legjislacionit ne fuqi te Republikes se Shqiperise.

#### NENI 3

Kjo shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, I perballon humbjet e saj deri ne kufirin e vleres se kapitalit themeltar.

### EMERTIMI, SELIA, OBJEKTI, KOHEZGJATJA

#### NENI 4

Emertimi i shoqerise tregtare me pergjegjesi te kufizuar eshte "V-MAX-2" sh.p.k.

#### NENI 5

Shoqeria tregtare me pergjegjesi te kufizuar "V-MAX-2" sh.p.k ka seline e saj ne Tirane Njesia Nr. 2, Rruga Skerdilajd Llagani, Kulla Nr. 3, Kati 1, perballe Juvenilja Castello, Tirane.  
Aktiviteti i shoqerise zhvillohet ne rrethin e Tiranës dhe do te shtrihet ne te gjithë teritorin shtetëror te Republikes se Shqiperise dhe jashte saj.

### OBJEKTI I VEPRIMTARISE

#### NENI 6

Sherbime te llojit, Kend lojrash per femije, Qender Ditere per femije, evenimente te ndryshme per femije.

#### NENI 7

Aktiviteti i shoqerise do jete me afat pa afat. Per shkaqe e arsye te ndryshme, ajo mund te mbylli kete aktivitet ose te shyjne afatin e aktivitetit sipas vendimeve te asamblese se ortakeve. Kjo do te behet ne perputhje me normat e Statutit dhe Legjislacionit ne fuqi.

## KAPITALI THEMELTAR I SHOQERISE

### NENI 8

Kapitali themeltar I shoqerise perbehet nga kontributi i ortakut I cili zoterohet ne kete menyre:

- Z. Klodiana Guzja zoteron 100% te aksioneve te kapitalit e barabarte me nje (1) kuote te kapitalit themeltar te shoqerise.

Kapitali themeltar eshte i ndare ne 1 (nje) kuote te kapitali, te gjitha te nenshkruara dhe te paguara, e cila eshte e barabarte me nje vlere nominale prej 100,000 leke (njeqinmije) lek.

Sipas kontributit te mesiperm kuotat zoterohen si me poshte:

### NENI 9

Kapitali themeltar mund te shtohet ose zvogelohet, ne varesi te rezultateve dhe ne perputhje me normat e legjislacionit ne fuqi.

### NENI 10

Kapitali themeltar mund te transferohet jashte shoqerise, ose te lihet peng, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

### NENI 11

Kapitali themeltar eshte lehtesisht I transferueshem ne rruge trashegimie. Bashkeshortja, paraardhesi dhe pasardhesit mund te behen ortake ne shoqeri nepermjet transferimit te pjeseve te kapitalit dhe sipas kushteve te parashikuara me ligj.

### NENI 12

Shoqeria mund te kete dhe kontribute te tjera ne natyre. Ketu perfshihen te gjitha sendet e paluajtshme ne sherbim te shoqerise si dhe ato te luajtshme, te cilat kalojne ne pronesi te shoqerise.

## FONDET E SHOQERISE

### NENI 13

Shoqeria percakton fondet:

- Fondi themeltar (qarkullues);Fondi reserve;Fonde te tjera, qe mund te jene te nevojshme gjate veprimtarise se saj.

Madhesia e secilit fond percaktohet mbi bazen e vendimit te organit drejtues, i cili merr vendim gjithashtu edhe per qellimin e perdorimit te tij.

## DREJTIMI ADMINISTRATIV.

### NENI 14

Shoqeria ka si organe drejtuese:

Ortaket e lartepemendur

Dhe Administratoret.

Administratori te shoqerise eshte

1. Z. Klodiana Guzja me ID I46130046A

Te zgjedhur per 2 vjet me te drejte rizgjedhje ose lergimit e tyre sipas vendimeve te asamblese se ortakeve.

### NENI 15

Ortaku i vetem per administrimin e shoqerise ose te aktiviteteve te vecanta te saj ka kopetence te emerj nje ose disa persona te tjere si administrator te shoerise. Kompetencat e administratoreve te mundshem percaktohen ne aktin e emerimit te tyre.

### NENI 16

Shoqeria nuk merr persiper veprimet qe mund te kryejne administratore te tjere te mundshem, ne marrdhenie me persona te trete qe I tejkalojne kompetencat e tyre te percaktuara ne aktin e emerimit.

### NENI 17

E gjithë veprimtaria e shoqerise administrohet nga administratori I saj ne perputhje me Statutin dhe legjislacionin ne fuqi.

### NENI 18

Administratori per te shqyrtuar bilancin vjetor, te ardhurat e qarkulluara, si dhe menyren e mbajtjes se regjistrave te veprimeve kontabel, emerone nje ose disa eksperte kontabel. Emerimi i eksperteve kontabel eshte I detyrueshem per rastet e parashikuara me ligj.

## ORTAKET TE DREJTAT DHE DETYRIMET

### NENI 19

- Percakton politikat tregetare te shoqerise.
- Ndryshimet e statutit.
- Emerone dhe shkarkon administratoret dhe percakton kompetencat e tyre ne aktin e emerimit.
- Percakton shperblimin e administratorit, te likujduesit dhe eksperteve.
- Mbikqyr zbatimin e politikave tregtare nga administratoret, pasqyrat financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se shoqerise.
- Zmadhimin apo zvogelimin e kapitalit.
- Shqyrton bilancin vjetor, kuotat e fondeve te ndryshme dhe fitimin e realizuar.
- Vendos per krijimin e filialeve, degeve ose perfaqesive te shoqerise si dhe per krijimin e shoqerive te perbashketa.
- Vendos per marrjen e kredive si dhe per mbarimin e aktivitetit te shoqerise, nese ne dokumentacionet financiare, rezultatet e shoqerise vleresohen me humbje.
- Realizon marrdheniet me te rendesishme financiare dhe ekonomike te shoqerise me persona te tjere fizike dhe juridike.
- Te caktoje dhe shkarkoje drejtues teknik sipas drejtimeve te veprimtarise qe do te ushtroje shoqeria (me kontrata pune).
- Riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.
- Miratimin e rregullave procedurale te mbledhjes se asamblese.

## MBLEDHJA E ASAMBLESE SE PERGJITHSHME

### NENI 20

Asambleja mblidhet sa here qe eshte e nevojshme per mbrojtjen e interesavete shoqerise, ne rastet e percaktuara me ligj, e ne te gjitha rastet jo me pak se nje here ne vit.

Ajo thirret nga administrator ose ortakët.

Thirret me shkrese ose nepermjet postes elektronike. Njoftimi duhet te permbaje vendin, ditën, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e dites, e t'u dergohet ortakeve jo me vone se shtate dite para dates se parashikuar per mbledhje. Ortaku mund te perfaqesohet ne asamble vete ose edhe nga nje person i autorizuar prej tij, ose ortak tjetër.

Administratoret nuk mund te veprojne si perfaqesues te ortakeve ne asamblene e pergjithshme. Autorizimi jepet per nje mbledhje te asamblese me te njejtin rend dite edhe nese vijon me shume se nje dite. Vendimet merren me shumice te thjeshte vote.

### KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT

#### NENI 21

Administratori i shoqerise ka per detyre:

- Te punoje, te drejtoje e te organizoje ne menyre te tille qe te siguroje suksesin e shoqerise ne veprimtarine e saj ekonomiko-financiare, sipas politikave tregtare te vendosur nga asambleja e pergjithshme.
- Te perfaqesoj shoqerine tregtare.
- Te kujdeset per mbajtjen e saktedhe te rregullt te dokumentave dhe te librave kontabel te shoqerise.
- Te pergatise dhe nenshkruaj bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar; dhe raportin e ecursie se veprimtarise dhe vazhdimesine e saj, se bashku me propozimin per shperndarjen e fitimeve dhe paraqit keto dokumenta para asamblese se pergjithshme per miratim.
- Te kryeje regjistrimet dhe te dergoj te dhenat e detyrueshme te shoqerisesic parashikohet ne ligj per QKR.
- Te raportoj para asamblese se pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare.
- Realizon dhe percakton cmimet e punimeve te kryera si dhe te shitjeve te artikujve te tregtuar.
- Nenshkruan kontrate pune me punemarres.
- Ndjek problemet e shoqerise ne marrdheniet me organe te ndryshme shteterore dhe me persona te tjere fizike dhe juridike, lidh kontrata em te trete.

### DREJTIMI TEKNIK I SHOQERISE

#### NENI 22

Per veprimtari ne fusha te vecanta (ne te cilat ligji percakton drejtim nga specialistet te licensuar), shoqeria do te punesoje me kontrata pune specialist te licensuar sipas fushes perkatese.

### MARRDHENIET FINANCIARE

#### NENI 23

Shoqeria mund te lidhe kontrata me sektore shteterore, drejtperdrejt me tregun e lire, si dhe me persona fizike e juridike, vendas ose te huaj.

#### NENI 24

Ne marrdheniet kontratore, shoqeria perfaqesohet nga administratori ose nga persona te autorizuar prej tij. Te drejtat dhe detyrimet qe rrjedhin nga kontratat jane te detyrueshme per shoqerine.

#### NENI 25

Shoqeria ka te drejte te plote te cele llogari likujduese prane bankave te vendit ose te huaja ne Shqiperi, shteterore ose private dhe te kryeje veprimet e likujdimit nepermjet tyre. Per sigurimin e veprimtarise ka te drejte te vetfinancohet ne leke ose ne valute te huaj.

#### NENI 26

Shoqeria pergjigjet per kontributet fiskale, afatet e derdhjes se tyre dhe sigurimet shoqerore. Personat e ngarkuar me kete detyre duhet te mbajne dokumentacin te rregullt financiar.

Administratori ne fund te vitit duhet te dorezoje ne organin tatimor perkates bilancin e te ardhurave per efekt te tatimit vjetor.

Viti financiar mbaron ne muajin dhjetor te cdo viti. Raportert dhe inventaret vjetore hartohen ne perputhje me dispozitat e ketij Statuti dhe legjislacionin ne fuqi.

### MARRDHENIET E PUNESIMIT

#### NENI 27

Administratori vendos per personat qe do te punesohen ne aktivitetin e shoqerise. Punesimi do te behet ne perputhje me aftesite profesionale te punemarresit.

#### NENI 28

Marrdheniet e punesimit regullohen sipas kontrates se punesimit qe lidhet midis paleve, ne baze te Kodtit te Punes dhe akteve ligjore e nenligjore ne fuqi. Ne kontrate caktohen kushtet e punes, te pageses, sigurimit ne pune, diteve te pushimit etj.

#### NENI 29

Administratori dhe personeli I shoqerise eshte I detyruar te respektoje disiplinën e punes, te ruaje dhe te mirmbaje pronen dhe te zhvilloje aktivitetin e shoqerise ne perputhje me ligjin.

#### NENI 30

Ndaj shkeljeve te ndryshme zbatohen masa disiplinore qe merren nga administrator. Punonjesi qe largohet nga puna duhet te beje dorezimet e detyres ne baze ten je akti me shkrim, pasi tge kete shlyer detyrimet materiale dhe monetare.

### PERGJEGJESIA E PUNONJESVE

#### NENI 31

Cdo punonjes i punesuar ne shoqeri eshte personalisht pergjegjes per kryerjen e detyres. Ai eshte I detyruar te permbushë detyrimet qe rrjedhin nga kontrata e punes, nga vendimet e administratorit dhe nga Statuti I shoqerise. Per shkelje te tilla dhe per shkelje te legjislacionit ne fuqi merren masa te ndryshme sipas ligjit.

### KONFIDENCIALITETI

#### NENI 32

Te gjithë personat qe do te punesohen ne shoqeri jane te detyruar te ruajne fshehtesine e dokumentacionit, te informacionit, te njohurive te fituara si dhe te cdo lloj materiali tjetër konfidencial. Ata duhet te adoptojne te gjitha masat e nevojshme per te parandaluar hapjen e ketyre qofte edhe pjeserisht.

### BILANCI DHE TE ARDHURAT

#### NENI 33

Te ardhurat neto, pas shlyerjes se detyrimeve fiskale, sigurimeve shoqerore dhe detyrimeve ndaj personave te trete, kalojne ne dispozicion te ortakut te vetem.

#### NENI 34

Pagesat e personelit behen sipas kushteve te percaktuara ne kontraten e punes dhe perqindjeve te tatimit te percaktuara nga organi administrative.

#### NENI 35

Ne rast te mbarimit te veprimtarise se shoqerise, fitimi I realizuar duke zbritur ose duke shtuar perqindjet e mbartura nga vitet e meparshme, kalojne ne dispozicion te ortakeve sipas mases se kuotave qe zoterojne ne shoqeri.

NENI 36

Cmimet e sherbimeve te ofruara ne shoqeri si dhe ato te tregtimit caktohen ne baze te parimeve te ekonomise se tregut te lire. Fitimet e realizuara I nenshtrohen tatimit vjetor te percaktuar ne dispozitat perkatese ligjore.

SHPERNDARJA E SHOQERISE

NENI 37

SHKRIRJA

SHOQERIA mbaron me te perfunduar afati I parashikuar nga Statuti, ose perpara perfundimit ne rastet e parashikuara nga ligji ose me ane te nje vendimi te asamblese se pergjithshme, dhe per shkaqe te tjera ligjore, falimentimi etj.

LIKUJDIMI

NENI 38

Ne rast mbarimi, SHOQERIA duhet te likujdohet, duke iu nenshtruar procedurave te likujdimit. Per te administruar kete procedure, asambleja e pergjithshme e ortakeve emeron nje ose disa likuidatore, te cilet paraqesin raportet perfundimtarembi gjendjen e aktivitetit dhe pasivitetit te SHOQERISE, mbi operacionet e likujdimit dhe mbi kohen e nevojshme per te perfunduar likujdimin.

NENI 39

Shoqeria mund te mbaroje eshte me ane te riorganizimit, nepermjet formave te thithjes ose te bashkimit.

NENI 40

Gjate fazes se likujdimit, pergjegjesia e administratorit dhe likuidatorit eshte e njejte.

DISPOZITA TE FUNDIT

NENI 41

Pasuria e shoqerise mund te sigurohet ne ndonje institut sigurimi.

NENI 42

Mosmarveshjet ne marredhenie me personat juridike e fizike, vendas e te huaj, zgjidhen me merkuptim, ne te kundert, gjykata kompetente eshte Gjykata e Rrethit Tirane.

NENI 43

Cdo gje tjeter ne kete shoqeri I referohet Ligjit Nr. 9901, date 14/04/2008 dhe cdo akti tjeter te legjislacionit shqiptar.

NENI 44

Shoqeria do te kete vulen e saj. Statuti I shoqerise u miratua nga ortakët dhe u nenshkrua rregullisht prej tij.

**ORTAKU I VETEM I SHOQERISE  
"V-MAX-2 SHPK"**

Klodiana Guzja

